



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/16
Datë: 01.12.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 1 dhjetor 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohen procesverbalet nga mbledhjet 12 dhe 13 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Ramush HARADINAJ
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/16
Datë: 01.12.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 1 dhjetor 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Aktet Juridike.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Ramush HADINAJ
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/16
Datë: 01.12.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe me Rregulloren nr. 14/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 1 dhjetor 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept Dokumenti për Fushën e Financimit të Subjekteve Politike.
2. Obligohet Zyra e Kryeministrit dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Ramush HADRI
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/16
Datë: 01.12.2017


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 10 paragrafi 10.1 pika (b), dhe të nenit 18 të Ligjit nr. 03/L-038 për Përdorimin e Simboleve Shtetërore të Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 1 dhjetor 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Komisioni Qeveritar për hartimin e Projekt rregullore për flamurin dallues të Qeverisë së Republikës së Kosovës; (tutje: Komisioni) në këtë përbërje:

1.1. Z. Selim Selimi	Këshilltar i Kryeministrit	kryesues;
1.2. Znj. Refiçe Ternava	Këshilltare e Zëvendëskryeministrit	anëtare
1.3. Z. Endrit Shala	Këshilltar i Lartë Politik i Zëvendëskryeministrit	anëtar;
1.4. Znj. Nora Cukaj	Këshilltare e Zëvendëskryeministrit	anëtare;
1.5. Znj. Snezana Karadzic	Këshilltare e Zëvendëskryeministrit	anëtare;
1.6. Z. Burim Krasniqi	Këshilltar i Lartë Politik i Zëvendëskryeministrit	anëtar;
1.7. Z. Mentor Borovci	Drejtor i Zyrës Ligjore - ZKM	anëtar;
1.8. Z. Arben Krasniqi	Drejtor i SKQ/ZKM	anëtar;
1.9. Znj. Besnike Mehmeti	Zyrtare e Lartë Ligjore - Zyra Ligjore ZKM	anëtare;
1.10. Znj. Atifete Haklaj	Ministria e Administratës Publike	anëtare;
1.11. Z. Mehdi Uka	Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit	anëtar;
1.12. Z. Isni Kryeziu	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	anëtar;
1.12. Znj. Venera Kosumi	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	anëtare.
2. Ftohen ta dërgojnë nga një përfaqësues:
 - 2.1. Kuvendi i Republikës së Kosovës;
 - 2.2. Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës;
 - 2.3. Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Filozofik/Departamenti i Historisë;
3. Me pajtimin e kryesuesit të Komisionit mund të ftohen edhe përfaqësues të Organizatave ndërkombëtare, organizata të Shoqërisë Civile si dhe persona tjerë.
4. Me qëllim të kryerjes efikase të aktivitetit të tij, Komisioni mund të formojë grupe punuese të përkohshme si dhe mund të angazhojë ekspertë për këtë çështje.

5. Në punën e tij, Komisioni mund të shfrytëzojë mbështetjen profesionale të institucioneve dhe organizatave përkatëse vendore dhe ndërkombëtare.
6. Komisioni është i obliguar që për punën e tij t'i raportojë Qeverisë kurdo që kërkohet raport për ecurinë e punës së Komisionit.
7. Zyra e Kryeministrit obligohet për sigurimin e kushteve materiale, teknike dhe kushteve tjera për punën e këtij Komisioni.
8. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Ramush HARADINAJ
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/16

Datë: 01.12.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 16 të Ligjit nr. 05/L-125 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-002 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 1 dhjetor 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrit të Financave për kursime dhe ndarje buxhetore, për vitin 2017.
2. Kursimet buxhetore në kategorinë e shpenzimeve të pagave dhe mëditjeve janë në shumë prej 11,000,000€ në Ministrinë e Financave në nën programin "Kontigjenca e Sigurimeve Shëndetësore" me kod 28200 nën kategoria 11810-fondet kontingjente në Ministrinë e Financave.
3. Mjetet nga pika 2. e vendimit në shumën prej 6,800,000 € ndahen për Ministrinë e Shëndetësisë në nën programin "Trajtimi Mjekësor Jashtë Institucioneve Publike Shëndetësore" me kod 71600 kategoria e shpenzimeve subvencione dhe transfere nën kategoria ekonomike 21110-subvencione për entitetet publike.
4. Mjetet nga pika 2. e vendimit në shumë prej 600,000 € ndahen për Ministrinë e Shëndetësisë në nën programin "Aftësimi Specialistik dhe EVM" me kod 90300 kategoria e shpenzimeve subvencione dhe transfere nën kategoria ekonomike 21110-subvencione për entitetet publike.
5. Mjetet nga pika 2. e vendimit në shumë prej 3,600,000 € ndahen për Ministrinë e Shëndetësisë në nën programin "Shërbimet Mbështetëse Administrative-Logjistike" me kod 71900 kategoria e shpenzimeve mallra dhe shërbime nën kategoria ekonomike 13630-furnizime mjekësore.
6. Obligohet Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
7. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Ramush HARADINAJ
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/16
Datë: 01.12.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 1 dhjetor 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Nisma për lidhjen e Marrëveshjes ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Kosovës, për pjesëmarrjen e Kosovës në Programin "Evropa për Qytetarët".
2. Obligohet Ministria e Integrimit Evropian të ndërmarrë të gjitha hapat në përputhje me legjislacionin në fuqi, me qëllim të finalizimit të tekstit përfundimtar të marrëveshjes.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Ramush HADINAJ
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/16
Datë: 01.12.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 1 dhjetor 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Nisma për lidhjen e Marrëveshjes bilaterale ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Dukatit të Madh të Luksemburgut në kuadër të Projektit të Bashkëpunimit Zhvillimor, KSV/019: Asistenca teknike në kontestin e Integritimit Evropian.
2. Obligohet Ministria e Integritimit Evropian të ndërrmarë të gjitha hapat në përputhje me legjislacionin në fuqi, me qëllim të finalizimit të tekstit përfundimtar të marrëveshjes.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.


Ramush HARADINAJ
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/16
Datë: 01.12.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 1 dhjetor 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma për lidhjen e marrëveshjes për Promovimin dhe Mbrojtjen e Investimeve ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Britanisë së Madhe.
2. Obligohet Ministria e Tregtisë dhe Industrisë që të zhvillojë negociatat me Britaninë e Madhe, me qëllim të finalizimit të tekstit përfundimtar të marrëveshjes, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Ramush HARADINAJ
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/16
Datë: 01.12.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe me Rregulloren nr. 14/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 1 dhjetor 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept Dokumenti për trajtimin e Partneritetit Publiko-Privat.
2. Obligohet Ministria e Financave dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/16
Datë: 01.12.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 29 të Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe me Rregulloren nr. 14/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, bazuar në Vendimin e Qeverisë së Kosovës nr.13/52 dt.14.12.2011 për pagesën e qirasë ndaj Kishës Ortodokse Serbe (KOS), Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 1 dhjetor 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Ndahen mjete financiare në vlerë prej 285,484.50 euro, për pagesën e qirasë për Kishën Ortodokse Serbe (KOS), për periudhën 31 muaj e gjysmë, në vlerë prej 9,063 euro për një muaj, borxh i cili është llogaritur deri me datë 15.07.2016.
2. Mjetet financiare sipas pikës 1. të këtij vendimi ndahen nga Shpenzimet e paparashikuara me kod 232, nën-programi Shpenzimet e paparashikuara me kod 13100, nën-kategoria ekonomike e rezervës me kod 38010.
3. Mjetet nga pika 1. transferohen në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, nën-programi 00900-Instituti i politikave sociale, kategoria e shpenzimeve mallra dhe sherbime, nën-kategoria ekonomike 14110-Qiraja për ndertesa.
4. Për zbatimin e këtij vendimi, obligohet Ministria e Financave dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Ramush HARADINAJ
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 11/16
Datë: 01.12.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4, 8, 44 dhe 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe me Rregulloren nr. 14/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 1 dhjetor 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M P R E L I M I N A R

1. Miratohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga realizimi i Projektit për zgjerimin e mihjes sipërfaqësore për eksploatim të thëngjillit për prodhim të energjisë elektrike për nevoja të Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK-Sh.A), Zona Kadastrale: Hade dhe Shipitullë (pjesa e mbetur), Komuna Obiliq, sipas tabelave të përshkruara nga evidencat kadastrale përkatëse për titullarët e pronave të paluajtshme, pozitën e tyre në kuadër të projektit të interesit publik si dhe sipërfaqeve të tyre, të cilat tabela paraqesin pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Obligohet Departamenti i Shpronësimit/MMPH që brenda 5 (pesë) ditëve të punës, pas nënshkrimit të këtij vendimi preliminar, t'i njoftojë pronarët dhe pretenduesit e tokave të cilat do të shpronësohen dhe brenda afatit prej 10 ditëve të punës pas miratimit të njëjtin ta shpallë në Gazetën Zyrtare të Kosovës, si dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovës.
3. Kundër këtij vendimi apo cilës do pjesë të tij kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike në Gjykatën Kompetente, subjekti kërkues dhe cili do person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme të prekur nga ky vendim.
4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (MMPH), Ministria e Financave, Korporata Energjetike e Kosovës (KEK-Sh.A) dhe Komuna e Obiliqit.
5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.


Ramush HARADINAJ
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 12/16
Datë: 01.12.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 7 paragrafi 5. të Ligjit nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 1 dhjetor 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet propozimi i Ministrisë së Financave për t'i rekomanduar Presidentit të Republikës së Kosovës dhënien e autorizimit Ministrit të Financave për nënshkrimin e Marrëveshjes së Kredisë në mes të Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD), për financimin e projektit për autostradën Kijevë - Zahaq.
2. I rekomandohet Presidentit të Republikës së Kosovës për dhënien e autorizimit për nënshkrimin e marrëveshjes nga paragrafi 1. i këtij vendimi, konform afatit të përcaktuar në nenin 7 të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.


Ramush HARADINAJ
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 13/16
Datë: 01.12.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 29 të Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 1 dhjetor 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Për mbështetje financiare të Asociacionit "Loyola Gymnazium" (ALG) në shumë prej 720,000,00 (shtatëqindnjëzetëmijë) euro, obligim i papaguar nga Memorandumi i Mirëkuptimit, datë 11.10.2004, të lidhur ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Asociacionit "Loyola Gymnazium" (ALG) dhe Komunës së Prizrenit.
2. Mjetet financiare sipas pikës 1. të këtij vendimi ndahen nga Shpenzimet e paparashikuara nën-programi Shpenzimet e paparashikuara me kod 13100 nën-kategoria ekonomike e rezervës me kod 38010 dhe transferohen në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në kodin 208, nën programi Administrata Qendrore me kod 11308, kategoria ekonomike subvencionet dhe transferet, nën kategoria ekonomike subvencionet për entitetet jopublike me kod 21200.
3. Për zbatimin e këtij vendimi, obligohet Ministria e Financave dhe Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit


Ramush HARADINAJ
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 14/16
Datë: 01.12.2017

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017 si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 1 dhjetor 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Për dhënien e pajtimit për përjashtim nga fushëveprimi i Ligjit Nr. 04/L-42 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës.
2. Qeveria pajtohet të përjashtojë nga fushëveprimi i këtij ligji për shkak të specifikave të çështjes që ndërlidhet me zbatimin e obligimeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës në zbatimin e Ligjit Nr. 05/L-053 dhe Ligjit Nr. 06/L-002 për Buxhetin e Republikës së Kosovës.
3. Mjetet financiare për zbatimin e këtij vendimi mbulohen nga programi 379 00 Mbrojtja Juridike dhe Mbështetja Financiare për Personat e Akuzuar potencial nga Dhomat e Specializuara.
4. Obligohet Ministri i Ministrisë së Drejtësisë të formojë një ekip negociues dhe zbatues të këtij vendimi që përfshinë:
 - Sekretari i Ministrisë së Drejtësisë;
 - Sekretari i Ministrisë së Punëve të Jashtme;
 - Sekretari i Ministrisë së Administratës Publike;
 - Kryetari i Bordit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Ramush HARADINAJ
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë